



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
KRYETARI

VENDIM

Nr. 6020 Datë 13.02.2017

**PËR PLANIN VJETOR PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË SHËRBIMIN CIVIL**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si dhe Urdhërit të Kryetarit nr.4444, datë 01.02.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës Përfundimtare të Aparatit të Bashkisë së Tiranës”, si rezultat i krijimit të vendeve vakante;

**VENDOSA:**

1. Për vitin 2017, në Shërbimin Civil të Bashkisë Tiranë do të rekrutohen në vendet vakante, 240 (Dyqindedyzet) nëpunës civil të kategorive dhe klasave të ndryshme si më poshtë:
  - 10 (Dhjetë) nëpunës civil, të Nivelit të Mesëm Drejtues;
  - 30 (Tridhjetë) nëpunës civil, të Nivelit të Ulët Drejtues;
  - 200 (Dyqind) nëpunës civil, të Kategorisë Egzekutive;
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Erion Veliaj**

